



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 208/1 Prot.

Elbasan, më 13.2.2024

Lënda: *Kthim Akti*

**BASHKISË LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr 107 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e Aktit tuaj Nr.5 datë 01.02.2024 "Për miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme nga fatkeqësi natyrore ( dëmtim të gjësë së gjallë) familjes së Z.Bajram Muraçi, banor në fshatin Arrëz, Njësia Administrative Qendër, bashkia Librazhd ", konstatojmë se Akti juaj është i pabazuar në ligj, pasi nuk përmbushen kriteret ligjore të V.K.M nr 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Përsa më sipër Akti juaj mbetet i pakonfirmuar.

Su gjerohet që rasti të trajtohet nga zëra të tjerë buxhetorë të Bashkisë.



207  
02.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHË  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Datë.01.02.2024

Nr. 642 prot  
/4

Nr.5 dt.30.01.2024

**PER DHENIE NDIHME FINANCIARE**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore .”,ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”,si dhe VKM-së nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare,për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “,Kreu III/3/e,Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 119 date 29.12.2023 Pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar .”Për dhenie të ndihmës financiare,për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (rënie zjarri,djegje bagëtish) në pronësi të Z.Bajram Muraçi,banorë i fshatit Arrëz ,NJ.A.Qendër,Bashkia Librazhd,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 30.01.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare si familje ne veshtiresi në masën 207,500 lekë për z. Bajram Muraçi fshati Arrëz Nj.Adm Qender ,Bashkia Librazhd .
2. Fondi prej 207,500 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2024 “Ndhmë Financiare “ në strukturën buxhetore si më poshtë:

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 1	606	207,500 lekë Ndhmë financiare

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori Financës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

SEKRETAR I KËSHILLIT  
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT  
Mitat BIÇAKU

